

Banka Boterore

Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore



Personi i kontaktit: Ana Gjokutaj me numër telefoni 2405 8788889
agjokutaj@worldbank.org

BANKA BOTERORE U JEP GRANTE OJQ-ve SHQIPTARE

TIRANE 25, Maj 2001 – Sot Banka Boterore u akordoi tete organizatave joqeveritare shqiptare (OJQ) grante ne një shume totale prej 30,000 dollarë amerikanë për zbatimin e projekteve në fushat e zhvillimit, gjinisë, minoriteteve etnike dhe medias. Kjo është hera e parë që Zyra e Bankës Botërore në Tiranë akordon grante për OJQ shqiptare nga Programi i saj i decentralizuar për Grante të Vogla.

Bordi i Jashtëm Këshillimor dhe Komiteti i Brendshëm për Përzgjedhjen e Granteve shqyrtuan me kujdes 71 propozime projektesh dhe nga këta përzgjedhën tetë për financim. Shuma e akorduar për çdo projekt varionte nga 3.000 - 4.500 dollarë amerikanë.

OJQ-te dhe projektet e mëposhtme janë fituesit e Programit të Bankës Botërore të Granteve të Vogla në Shqipëri për vitin 2001:

- ❑ **Shoqata Kombëtare Shqiptare e Debatit**
per projektin "Qeveria duhet të kujdeset për të varfërit e saj"
- ❑ **Shoqatat FILD & SEDA**
me projektin "Pjesëmarrja e komunitetit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në komunën e Përrenjasit dhe Librazhdit"
- ❑ **Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Komunitetit**
me projektin "Unifikimi dhe zhvillimi i një lagjeje në Lushnje"
- ❑ **Qendra e Gruas**
me projektin "Fillo të përmirësosh biznesin tënd"
- ❑ **Shoqata e gazetarëve profesioniste "Joniane"**
me projektin "Mbrojtja e lidhjeve të minoriteteve etnike duke rritur rolin e medias së pavarur elektronike në nënprefekturën e Sarandës"
- ❑ **Shoqara e Kursim-Kreditit në Kuqan, Elbasan**
me projektin "Përmirësimi i furnizimit me ujë në fshat"
- ❑ **Shoqata e Perdoriesve Gjenetike te prodhimit te farerave**
me projektin "Rritja e të ardhurave të fermerëve përmes prodhimit farave të hibridit të certifikuar të misrit në Baldushk"
- ❑ **Unioni LEGA**
me projektin "Media në zbatimin e GPRS-së"

Programi i Granteve të Vogla është krijuar për të nxitur dialogun dhe shpërndarjen e informacionit mbi zhvillimin, si edhe për të thelluar partneritetin me shoqërinë civile.